

**2 Kriza e koronës dhe shtëpitë e pleqve**  
Mbrotjtje më e mirë e personelit dhe banorëve

**3 Intervista me ekspertin shëndetësor**  
Pse duhet të vaksinohemi kundër koronavirusit

**4 Të drejtat e diasporës dhe zgjedhjet në Kosovë**  
Demokracia, përfshirja dhe përfaqësimi

Nr. 1 | Shkurt 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kundër ashpërsimit të ligjeve të migracionit

## Sepse varfëria nuk është krim

# ARMUT

# IST KEIN

# VERBRECHEN!

E djathta ksenofobe nën petkun gjoja të luftimit të krimit, me mashtime është duke kriminalizuar varfërinë. «VARFËRIA NUK ËSHTË KRIM!»

**E drejta për mbështetje në situatë emergjente është një e drejtë themelore. Kjo është e ankoruar edhe në kushtetutë dhe është në dispozicion të të gjithë njerëzve në Zvicër. Mirëpo, faktikisht migrantet/ët nuk mund të shfrytëzojnë këtë të drejtë. Pasi kështu ata për shkak të ndihmës sociale mund të humbasin lejen e qëndrimit ose qëndrimit të përhershëm dhe të dëbohen nga Zvicra. Aleanca dëshiron të luftojë këtë diskriminim ndaj migrantëve/eve.**

Marília Mendes

Në fillim të krizës së Koronës, në mediat zvicerane mund të shiheshin pamje tronditëse. Në qytetet e pasura si Gjenera dhe Cyrihu, njerëzit prisnin në radhë të gjata për shpërndarjen e paketave të ushqimit. Shpesh fjala është për migrant/e me qëndrim të rregullt në Zvicër që për shkak të krizës së Koronës ishin në nevojë. Pse ata nuk u regjistruan në zyrën e mirëqenies sociale për marrje të ndihmës sociale? Për shkak se kishin frikë të rrezikonin të drejtën e tyre të qëndrimit në Zvicër. Shumë migrant/e humbën (dhe vazhdojnë të humbin) vendet e tyre të punës për shkak të krizës së Koronës. Ata nuk duan të rrezikojnë që të dëbohen nga Zvicra.

### Instrumentalizimi i ndihmës sociale

Kjo është e mundur sepse migrantet/ët mund të dënohen për ushtrimin e një të drejte. E drejta për ndihmë në nevojë është një e drejtë themelore. Por njerëzit pa pasaportë zvicerane që marrin ndihmë sociale mund të humbasin lejen e qëndrimit ose atë të qëndrimit të përhershëm dhe madje edhe të dëbohen nga Zvicra. Që kur Ligji për të Huajt dhe Integritim (AIG) hyri në fuqi në janar 2019, kjo mund t'u ndodhë të gjithë migrantëve/eve, pavarësisht sa gjatë ata jetojnë në Zvicër. Edhe nëse

ata janë lindur apo rritur këtu. Në këtë mënyrë, ligji për migracionin instrumentalizon situatën e njerëzve në nevojë dhe marrjen e ndihmës sociale si një mekanizëm për kontrollimin e migracionit.

### Kundër politikës represive të migracionit përmes shërbimeve sociale

Ashpërsimi i ligjit për të huajt është padrejtësi dhe duhet të korrigjohet. Për këtë qëllim, Partia Socialdemokrate (PS), sindikata Unia, SBAA dhe SAH Cyrih kanë krijuar një aleancë mbipartiake. Sepse të varfëritë nuk duhet që për varfërinë e tyre të diskriminohen dhe të ndëshkohen dyfishë. Samira Marti, deputete nacionale e PS, në emër të të gjithë anëtarëve të aleancës, theksoi: «Unë dua një shtet të mirëqenies që njerëzit i çliron e jo t'i tronditi. Momentalisht po ndodh e kundërta. Të huajt janë veçanërisht të ekspozuar kësaj tronditjeje, sepse rrezikohet e drejta e tyre e qëndrimit. Ky trajtim i pabarabartë, që ndjekin shërbimeve sociale përmes politikave represive të migracionit, më shqetëson jashtëzakonisht».

### Synimet e Aleancës

Aleanca synon që ashpërsimin e ligjit për migracionin ta adresojë në debatin publik dhe për-

mes hapave konkretë të ndërmarren kundërmasa. Njerëzit e prekur potencialisht duhet gjithashtu të thonë fjalën e tyre. Hilmi Gashi, Drejtues i Departamentit të Migracionit në Unia, mendon se «është çështje e vetëvendosjes të ngrihesh për të drejtat njerëzore dhe të luftosh padrejtësinë. Prandaj shpresojmë për një pjesëmarrje të madhe të shoqatave të migracionit». Ashtu si Samira Marti, edhe Aleanca nuk dëshiron «të bëjë politikë me maninë e avokimit për të prekurit, por më tepër bashkë me ta të luftojë për të përmirësuar situatën e tyre». Për të rritur presionin mbi institucionet, organizatat e shoqërisë civile duhet të qëndrojnë të bashkuara dhe të ngrënë zërin e tyre. Aleanca «Varfëria nuk është krim» siguron një kornizën të mirë për këtë.

Shoqatat e organizatat e migrantëve mund të regjistrohen këtu: <https://sp-ps.typeform.com/to/kuzX-1GRS>. ose mund të shkruajnë një E-mail në [pol@unia.ch](mailto:pol@unia.ch).

Dhe ne të gjithë, me ose pa një pasaportë zvicerane, mund të nënshkruajmë peticionin e Aleancës për parlamentarët dhe të mbështesim aktivitetet e tjera: <https://poverty-is-not-a-crime.ch/de/>

### Editorial



#### Me solidariteti nga kriza – tani është radha jonë!

Pandemia e koronës vazhdon të mbërthejë Zvicrën edhe më tej. Ajo përpos vuajtjes njerëzore me veti përbën një të ardhme të paqartë. Që kostoja e krizës të mos u ngarkohet mbi supë punëmarrësve, për ne shmangia e pasojave më të këqija të krizës do të ketë përparësi të lartë në muajt e ardhshëm. Në rast të shkarkimeve nga puna edhe me masa kolektive luftarake.

Mirëpo, vetëm rezistenca nuk mjafton. Për të ruajtur aftësinë e veprimit, duhet të orientohemi drejt përparësive të politikës së përbashkët sindikale. Motoja «Me solidaritet nga kriza – tani është radha jonë» shërben si një fije e kuqe për aktivitetet tona të fushatës transversale në vitin 2021. Ajo brenda vetit përfshinë rreth tre terminë mobilizues të fushatës përkatëse: 1) Me 12 maj: «Solidariteti në mbrotjtjen e shëndetit» me «Ditën e përkujdesjes»; 2) Me 14 qershor: «Përmirësimi i profesioneve të grave» përmes aktivitete të decentralizuara; dhe 3) Me 18 shtator: «Bartja solidare e pasojave të krizës» me një demonstratë kombëtare si pika kryesore e mobilizimit.

Përmes këtyre mobilizimeve, ne duam përmirësimin e parakushteve për të arritur përparim në Kontratën Kolektive të Punës, për të siguruar fuqinë blerëse dhe vendet e punës, për parandalimin e çrregullimeve të reja, për të realizuar paga të barabarta dhe për zbatim të masave mbrotjtëse në vendin e punës. Për më tepër, ne duam të mbështesim zhvillimin afatgjatë në profesionet e përkujdesjes dhe të forcojmë perceptimin e Unia si një sindikatë për profesionet e shërbimit, e cila është veçanërisht e angazhuar për kushte më të mira të punës për gratë.

Vania Alleva

## News

## Përfitimë shtesë për të papunët e moshuar

Ligji federal i përfitimëve shtesë për të papunët e shtyrë në moshë (ÜL/PC) do të hyjë në fuqi në pjesën e dytë të vitit 2021. Me ligjin e ri, personat të cilët me moshën 60 vjeç mbesin të papunë përtej periudhës së siguruar, duhet që deri në arritjen e moshës së pensionimit të rregullt të marrin përfitim kalimtar shtesë (ÜL/PC). Kjo vlen vetëm nëse ata kanë qenë mjaftueshëm të punësuar në Zvicër dhe që posedojnë pak pasuri. Më 18 dhjetor 2020, parlamenti vendosi që edhe ata persona që nga 1 janari 2021 kanë humbur të drejtën e përfitimit nga sigurimi i papunësisë dhe që plotësojnë të gjitha kushtet e tjera mund të kërkojnë përfitimë shtesë që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit federal. Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://www.bsv.admin.ch/bsv/de/home/sozialpolitische-themen/soziale-absicherung/aide-aux-chomeurs.html>.

## Interes mediash mbi problemet e pastërtisë dhe sigurisë në kantiere

Në kantiere – veçanërisht tek mjeshtëritë instaluese – situata e higjienës është përkeqësuar për shkak të pandemisë. Tuletet e papërdorshme ose mungesa e dhomave të pushimit pa nxehe janë shpesh pjesë e përditshmërisë; por tani kësaj i shtohen edhe mosrespektimi i masave mbrojtëse dhe restorantet e mbyllura. Media në Zvicërën frëngjisht-folëse dhe gjermano-folëse janë të interesuara për këto tema, p.sh. Blick, Telebielinge ose Tagesanzeiger.

Unia u bën thirrje punëmarrësve të tregojnë përvojat e tyre, kështu që ne do të mund t'i vejmë në pah problemet dhe të ndërhyjmë tek punëdhënësit.



## Mbledhja e delegatëve të sektorit terciar: «Ne nuk paguajmë çmimin e krizës!»

Në takimin e tyre virtual me 25.1.2021, delegatët e sektorit terciar aprovuan një rezolutë për të mbështetur punonjësit në krizën e koronës. Si punëmarrës, të cilët për më shumë se një vit janë përballur me sfida të veçanta, ata tani më shumë se kurrë meritojnë kushte të sigurta pune, si dhe për pagë e kompensim për punën me kohë të shkurtuar, që mjafton për të jetuar.

Përveç kësaj, «Çmimi për angazhim» iu dha anëtarëve të Unias të cilët u dalluan përmes veprimeve të tyre të guximshme. Këtë vit çmimi shkon për Amandine Barutz Jutzeler (infermiere) dhe Clotilde Pinto (shitëse) si dhe për dy kolektive që luftuan me sukses kundër shkarkimeve të planifikuara masive në kompaninë e tyre.

Shtëpitë e pleqve dhe të përkujdesjes në rrezik të madh  
Mbrojtje më e mirë për personelin dhe banuesit e domosdoshme

Shumica dërrmuese e të gjitha vdekjeve nga kurora ndodhin në shtëpitë e pleqve dhe të përkujdesjes. Mutacioni i ri i koronavirusit i përball ato me rreziqe edhe më të mëdha. Në vend që shtëpitë e pleqve të lënë vetëm, qeverisë federale dhe kantoneve u kërkohet të marrin masa më efektive mbrojtëse: kërkohen teste të rregullta, gjithëpërfshirëse Covid-19 në shtëpitë e pleqve si dhe duhet që kujdestarët e infektuar të jenë në gjendje të izolojnë vetveten.

Hilmi Gashi

Që nga fillimi i pandemisë së koronës, më shumë se 4000 banorë të shtëpive të pleqve e pakujdesit në të gjithë Zvicrën kanë vdekur nga virusi. Personeli në shtëpi të pleqve për muaj me radhë ka qenë nën presion. Përpjekja shtesë në kujdes, për shkak të sëmundjeve, rritjes së mungesës së personelit dhe shoqërimit të njerëzve që vdesin dhe atyre që kanë nevojë për kujdes, bënë që kujdestarët të kenë ngarkesë të madhe.

## Test gjithëpërfshirës në shtëpitë e pleqve më se i nevojshëm

Mutacionet e virusit paraqesin sfida të reja për shtëpitë e pleqve. Rastet e para tregojnë shpejtësinë e tmerrshme me të cilën virusi i ri mund të përhapet në shtëpitë e pleqve.

Unia kërkon nga Federata dhe Kantonet masa të menjëhershme dhe efektive. Këto nënkuptojnë kryerjen e teste të rregullta, gjithëpërfshirëse të kurorës për banorët dhe kujdestarët. Rezultatet pozitive të testit posaçërisht tek personeli duhet të çojnë në izolim të qëndrueshëm.

## Të mos lihen vet shtëpitë e pleqve

Testimi gjithëpërfshirës i punonjësve dhe atyre që kanë nevojë për kujdes do të jetë intensiv dhe mungesa e stafit do të përkeqësohet kur kujdestarët e sëmurë shkojnë në izolim. Qeveria federale dhe kantonet duhet të mbështesin shtëpitë e pleqve në përputhje me rrethanat: nga njëra anë, ata duhet të marrin përsipër shpenzimet e testeve, nga ana tjetër, ata duhet të sigurojnë staf shtesë për të kryer testet dhe për të siguruar përkujdesjen - qoftë përmes krijimit të stafëve shtesë të personelit, mbrojtjes civile ose shërbimit komunar ose, nëse është e nevojshme, pjesëtarëve të ushtrisë.

## Të mënjanohet reduktimi i vendeve të punës

Për shkak të zvogëlimit të numrit të pranimeve dhe rasteve të vdekjeve, pandemia në shumë shtëpi pëlqesh po çon në zënie të ulët të shtretërve. Sidoqoftë, financimi i shtëpive të pleqve dhe vendeve të punës varen nga shtretërit e zënë. Prandaj ekziston rreziku që këto humbje dhe kostot shtesë të luftimit të pandemisë t'i kalohen stafit dhe të shkurohen vendet e punës. Kjo nuk duhet të ndodhë! Qeveria federale dhe kantonet duhet të mbështesin shtëpitë e pleqve financiarisht. Pasi që, edhe pas pandemisë, shtëpitë e pleqve kanë nevojë për personel të mjaftueshëm, nëse jo shtesë, për të siguruar përkujdesje të mirë dhe dinjitoze.

## Situatë dëshpëruese në degën e gastronomisë

## Partnerët social kërkojnë kontribute të A-fonds-perdu

Pandemia po ndikon rëndë në industrinë e gastronomisë. Së bashku me partnerët socialë, Unia po kërkon mbështetje të shpejtë për industrinë e gastronomisë nga Qeveria Federale. Në funksion të krizës së vazhdueshme të kurorës, kërkohen menjëherë kontributet e A-fonds-perdu.

Për shkak të rritjes së infeksioneve me koronavirusin, Qeveria Federale ka forcuar masat. Këto masa kanë çuar në mbylljen e shumicës së bizneseve në industrinë e gastronomisë dhe në kufizime të rënda për të tjerët.

## Mungojnë paratë

Situata për mijëra ndërmarrje është dëshpëruese; shumë prej tyre tashmë është dashur të mbyllën përfundimisht dhe dhjetëra mijëra vende pune janë humbur ose do të humben. Fatkeqësisht, pagesat e premtuara të kompensimit zëvendësues (rregulli i rasteve të vështira) nuk kanë arritur ende tek ndërmarrjet. Edhe nëse atyre u duhen urgjentisht këto para. E pa-

qartë dhe e paparashikueshme gjithashtu është se cilat ndërmarrje mund ta llogarisin në këtë dhe kur do të rrjedhin paratë.

## Mbrojtja e shëndetit dhe siguria shoqërore

Përgjegjësia e përbashkët midis Qeverisë Federale dhe 26 kantoneve në funksion të situatës së jashtëzakonshme të krizës është treguar të jetë tejet letargjike. Mbrojtja e shëndetit dhe sigurimet shoqërore duhet të ecin krahas për krahas. Tani ekziston një nevojë urgjente për burime financiare shtesë për të mbrojtur vendet e punës në sektorët që është dashur të mbyllën për shkak të mbylljeve ose janë kufizuar rëndë nga mbylljet e pjesshme.

## Kontributet e A-fonds-perdu

Partnerët socialë përmes një letre të nënshkruar bashkërisht, i bëjnë thirrje Qeverisë Federale të marrë masa të mëtejshme sa më shpejt të jetë e mundur për të siguruar mbijetesën e industrisë së gastronomisë. Konkretisht, sindikatat Unia e Syna dhe shoqatat SCA e GastroSuisse, Hotel & Gastro Union, HottellerieSuisse kërkojnë që kontributet e A-fonds-perdu të vihen në dispozicion sa më shpejtë me anë të një urdhërese urgjente. Këto menjëherë duhet të paguhet për kompanitë dhe në mënyrë uniforme në të gjithë Zvicrën.

## Në 2021, arsimim i shumëkërkuar me Progresso:

## Për të gjithë që s'kanë diplomë në gastronomi

Si punonjës/e i/e kualifikuar keni më shumë shanse në gjetjen e vendit të punës dhe për ndërmarrjen sillni më shumë produktivitet dhe kualitet. Kjo vlen posaçërisht në situatën aktuale dhe atë në vijim. Falë arsimimit të mëtejshëm do të jeni më profesional dhe më efikas dhe ofroni shërbime më të mira, jeni të angazhuar më shumanshëm në punë, lehtësoni punën ekipore dhe rrisni kënaqësinë e myshterinjve – me çka fitojnë të gjithë!

Nuk keni akoma një diplomë në gastronomi? Atëherë ideale për ju është Progresso, që njihet në të gjithë Zvicrën. Kurset në lami të kuzhinës, të shërbimeve dhe mirëmbajtjes janë në dispozicion në të gjitha regjionet. Ne rekomandojmë që kur të regjistroni, të rezervoni që të tri pjesët e kursit. Kështu ndërmarrja në të cilën punoni mund të planifikojë në mënyrë optimale mungesat tuaja.

Progresso financohet përmes programit të arsimit të mëtejshëm [www.weiterbildung-inklusive.ch](http://www.weiterbildung-inklusive.ch). Falë Kontratës Kolektive të punës L-GAV, Progresso (vlera 3450 CHF) është falas për punonjësit që i nënshtrohen kontratës L-GAV. Për më tepër, mbulohen shpenzimet për materiale mësimore, shujtat, bujtja për çdo qëndrim gjatë natës për absolventët e kursit dhe një pjesë e mirë e kompensimit të pagës.

Çka mësoni në kurs dhe çka duhet të dini për provim? Të gjitha videot i gjeni në Youtube duke kërkuar në <https://www.youtube.com/c/WeiterbildungInklusive/videos>

Lajmërimi dhe informacione tjera:  
Tel. 041 392 77 77,  
[progresso@hotelgastro.ch](mailto:progresso@hotelgastro.ch), [www.mein-progresso.ch](http://www.mein-progresso.ch)



Demokracia dhe diskriminimi

«Të paguhet tatimi, por edhe të votohet»

Për më shumë se 100 vjet, lëvizjet politike dhe sindikale në Zvicër janë mobilizuar në luftën për një demokraci barazimtare. Ato vazhdimisht konfrontoheshin me rezistencën kokëfortë të forcave reaksionare. Pesëdhjetë vjet më parë, Zvicra zbatoi - edhe pse si një nga vendet e fundit në Evropë - të drejtën e grave me shtetësi zvicerane për të votuar. Por edhe më tej ka pabarazi midis grave dhe burrave. Dhe pabarazia midis shtetasve dhe jo-shtetasve po rritet. Le ta shfrytëzojmë përvjetorin e 50-të si një mundësi për të folur për këto pabarazi - dhe atë se çka i del në rrugë ende si pengesë votimit për të gjithë.

Julius Kopp, Marie Saulnier Bloch, Osman Osmani

Luftë e gjatë feministe për të drejta politike dhe barazi

Më 7 shkurt 1971, grave me shtetësi zvicerane iu dha e drejta e votimit dhe e zgjedhjes. Kjo si rezultat i betejave të gjata dhe të hidhura: votimi i grave kishte qenë edhe njëra nga kërkesat e grevës së përgjithshme të vitit 1918. Zbatimi i kësaj të drejte nxiti luftën e grave. Më 14 qershor 1981, barazia midis grave dhe burrave u fuqizua në kushtetutën federale, ndërsa që ligji përkatës i barazisë hyri në fuqi në 1996. 50 vjet e të drejtës të votimit dhe të të zgjedhurit, 40 vjet të Ligjit të Barazisë, 25 vjet të Aktit të Mundësive të Barabarta. A është 2021, viti i përvjetorëve, një vit festimi? Po, por edhe mobilizim, sepse pabarazia mbetet e kudogjendur dhe demokracia zvicerane është larg të genit barazimtare.

Pabarazitë e vazhdueshme në rritje

Ndërsa qeveria federale dhe parlamenti janë bërë më femërore, gratë mbeten të nën-përfaqësuar në qendrat e pushtetit politik, ekonomik dhe shoqëror. Ata janë gjithnjë e më shumë viktime të diskriminimit dhe dhunës, si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik. Këto janë vetëm dy nga shumë arsye pse më



shumë se 500 000 njerëz morën pjesë në grevën e grave në vitin 2019. Përveç pabarazisë midis burrave dhe grave, ekziston një hendek në rritje midis njerëzve me një pasaportë zvicerane dhe personave që nuk u epet ajo. Kriteret për natyralizim po bëhen më të rrepta dhe në të gjithë Evropën, tani Zvicra është vendi me mbrojtjen më të dobët ndaj diskriminimit. Ne jetojmë në një sistem politik të ndarjes juridike, shoqërore, ekonomike dhe politike. Megjithatë shoqëria nuk do të mund të funksiononte pa rreth 2 milion gra dhe burra që s'kanë pasaportë zvicerane, e që zërat e tyre nuk dëgohen fare. Sa më pak vëmendje të ketë kjo pjesë e madhe e popullatës zvicerane, aq më shumë duhet të ngrenë zërin të gjithë ne.

Të drejtat e barabarta menjëherë!

Në 1969 Emilie Lieberherr në fjalimin e saj në sheshin federal nxiti mbështetësit e të drejtës së grave për të votuar dhe të drejtën e zgjedhjes për të ngritur zërin bindshëm: «Paguaj taksat, por edhe voto e zgjedh». Kushdo që merr pjesë ekonomikisht në një shoqëri duhet të posedon gjithashtu të drejtat e plota civile. Edhe sa kohë duhet të presim? Le të fillojmë që tani të mobilizohemi për demokracinë e vërtetë. Le të luftojmë për të drejtën e votës për të gjithë, me vendosmëri dhe me solidaritet të pakushtëzuar.

**Thirrje për dëshmi: Fëmijë «e fshehur» të sezonierëve (1946–2002)**

A keni qenë si fëmijë i prekur nga ndalimi sa i përket bashkimit familjar për punëtorët sezonalë të huaj? Dhe a ju është dashur nga koha në kohë të jetoni si një fëmijë sezonal «i fshehur» në Zvicër? Tani jam duke studiuar këtë temë si pjesë e një projekti në historinë moderne që ka nisur Prof. Kristina Schulz, drejtuese e Institutit Historik në Universitetin e Neuchâtel.

Prandaj, jam shumë i interesuar për një bisedë ose një shkëmbim me njerëzit e prekur\*. Në mënyrë që të kuptoj më mirë historinë e tyre, unë jam mirënjohës për çdo informacion ose kontakt.

Magali Michelet, doktorante e historisë moderne, Universiteti i Neuchâtel.

Ju lutem më kontaktoni në: magali.michelet@unine.ch ose 079 576 29 14

Informacione të mëtejshme mbi projektin kërkimor: [www.unine.ch/shm](http://www.unine.ch/shm).

\* Të gjitha të dhënat në kontekstin e këtij projekti kërkimor, varësisht nga dëshira e të interesuarve mund të përpunohen në mënyrë plotësisht anonime.

KKP e re për degën e floktarëve (parukerisë)

I epet fund dumpingut në paga dhe presionit në çmime

Sindikatat Unia dhe Syna si dhe shoqata e degës së floktarëve Coiffure Suisse janë të kënaqur që Qeveria Federale dhjetorit 2020 ka deklaruar përgjithësisht të detyrueshme kontratën kolektive të punës GAV për degën e floktarëve. Kjo do të thotë që mbrojtja e punonjësve do të vazhdojë pa ndërprerje.

Igor Zoric, anëtar i drejtorisë së degës terciare

Kontrata e re për degën zvicerane të floktarëve hynë në fuqi nga 1.1.2021. Paraprakisht, partnerët social janë pajtuar për zgjatjen e Kontratës kolektive të punës deri më 31.12.2022. Kontrata e re parasheh nga 1 janari 2021 një ngritje të pagës minimale për 30 franga në muaj për punonjësit nga viti i 5'të i ushtrimit të profesionit. Përmes KKP përmirësohen dhe mbrohen kushtet e punës për 11 550 punonjës/e.

Bilanc pozitiv i partnerëve social

Partnerët social bëjnë një bilanc pozitiv mbi veprimtarinë e zgjeruar të kontrollit

në këtë degë. Kështu i jepet fund dumpingut në paga dhe presionit në çmime në këtë degë industriale. Gjithashtu është treguar i dobishëm edhe koncepti mbrojtës nga Korona i përpiluar nga Coiffure Suisse në marrëveshje me partnerët social. Për partnerët social prioritet të lartë ka gjithashtu zbatimi i rreptë dhe që dega në fjalë të japi një kontribut të rëndësishëm për mbrojtje të punëmarrësve dhe për mbajtje nën kontroll pandeminë.

Për informacione më të detajuara drejtohu ni tek sekretariati i Unia në afërsinë Tuaj.



Intervista



Vaksinimi kundër koronës

Pandemia e koronës na venë para sfida të mëdha. Edhe në fushën e shëndetësisë. Vaksinimi është mënyra më e mirë për të marrë nën kontroll pandeminë dhe për të mbrojtur njerëzit. Një intervistë me Dr. Christoph Hatz jep përgjigjet e nevojshme.

**Emine Sariaslan (ES): Pse neve në përgjithësi na nevojiten vaksinimet?**  
 Christoph Hatz (CH): Vaksinimet ekzistojnë që më shumë se 200 vjet, e para ishte kundër lisë. Vaksinimet kanë bërë që sëmundjet infektive të zvogëlohen në mënyrë dramatike.

**ES: Mirëpo pse ka gjithmonë kundërshtarë të vaksinimit?**  
 CH: Ka disa arsye. Disa refuzojnë ndërhyrjet në trup, sepse thjesht nuk është e natyrshme aplikimi i një substance «të huaj». Më tej, sikur me sëmundjet ashtu edhe me vaksinat mund të ndodhin çrregullime shëndetësore. Në rastin e sëmundjes, flitet për simptoma, në rastin e vaksinimeve të efekteve anësore, gjë që në thelb është e njëjta. Vaksinimet mund të kenë efekte anësore, megjithatë kryesisht janë të natyrës së padëmshme, siç po shohim deri më tani me vaksinimin aktual të COVID-19.

Kundërshtarët e vaksinimeve besojnë se industria do të fitojë shumë para me vaksinat. Në rastin e COVID, kjo mund edhe të jetë e vërtetë, që zhvilluesit dhe prodhuesit të mund të fitojnë shumë para. Me shumicën e vaksinimeve themelore, të tilla si tetanus, poliomieli, fruthi dhe të tjerat, sasia e fitimit është aq e vogël sa shumë kompani nuk prodhojnë më vaksina. Dhe së fundmi: Me vaksinat, ne nuk ndërhyjmë në pellgun e gjeneve njerëzore, por lëndojmë integritetin e trupit përmes një injeksioni. Sidoqoftë, vaksinimet kanë të paktën dy përparësi vendimtare. Mbrojtja individuale e personave të vaksinuar kundër sëmundjeve ndonjëherë fatale është e garantuar në pothuajse të gjitha rastet. Së dyti, vaksinimi është gjithashtu një akt solidariteti brenda shoqërisë. Me vaksinimin, ata jo vetëm që mbrojnë veten, por edhe të gjithë përreth tyre.

**ES: A jeni vaksinuar vetë kundër Covid-19??**  
 CH: Unë sigurisht që kam marrë vaksina të shumta. Unë punoj në një spital kantonial dhe atje kam kontakte me pacientë me rezik të lartë, andaj edhe jam vaksinuar.

**ES: Sa efektive është vaksina COVID-19?**  
 CH: Ne e dimë nga studimet, që hulumtuan një numër të madh të njerëzve të vaksinuar, se mbrojtja pas vaksinimit të plotë, d.m.th. 7-10 ditë pas dy dozave, është mbi 90%. Kjo me këto dy vaksinat e reja (mARN) tregon një vlerë sensacionale, të cilën unë personalisht nuk e prisja kurrë. Vaksina e tretë, të cilën ne ende nuk e disponojmë (gjendja me 26 janarit 2021), ofron mbrojtje ndërmjet 60%-80% (kjo është gjithashtu relativisht e mirë). Ne jemi jashtëzakonisht me fat me këtë vaksinim. Sigurisht, dëmi afatgjatë i njerëzve individualë nuk mund të përjashtohet, por nëse shikojmë përfitimet e përgjithshme, atëherë duhet të themi: «Ne duhet të jemi në gjendje të jetojmë me këtë situatë».

**ES: Në Danimarkë, 23 persona kanë vdekur pasi janë vaksinuar kundër COVID-19. Në Zvicër, personat mbi 75 vjeç janë të parët që vaksinohen. A është kjo strategjia e duhur, nëse të moshuarit nuk mund të durojnë këto vaksina dhe të vdesin prej tyre??**

CH: Kjo është një dilemë. Veçanërisht njerëzit e moshuar mund të vdesin nga COVID-19. Për të parandaluar këto vdekje në shtëpitë e pleqve dhe përkujdesjes, u vendos në Zvicër që së pari të vaksinohen këta njerëz. Në vendet e industrializuara, njerëzit jetojnë më gjatë. Probabiliteti është më i lartë se ata mbi 80 vjeç kanë më shumë të ngjarë të vdesin sesa ata nën 70. Tek rastet e deritashme, përfshirë edhe rastet nga Danimarka, nuk është provuar se ishte vaksinimi ai që shkaktoi vdekjen. Jeta mbi 80 vjeç është po aq e denjë për mbrojtje. Kjo është arsyeja pse rinjtë gjithashtu duhet të bashkë-përfshihen dhe të kufizojnë veten në aspektin social dhe të mos bëjnë festa. Dhe e gjithë kjo deri më tani ka funksionuar mjaft mirë.

**ES: A mbrojnë vaksinat Covid-19 gjithashtu nga format e mutacionit?**  
 CH: Deri më tani ne e dimë se 3 vaksinat gjithashtu ndikojnë kundër viruseve të ndryshura. Shifrat nga Britania e Madhe kanë treguar se forma e ndryshuar është më ngjitëse. Sigurisht, nëse një sëmundje është më ngjitëse, më shumë njerëz do të infektohen dhe mund të sëmurën. Kur më shumë njerëz kanë zhvillime përqendrimi më të rënda, përfundimisht do të vdesin më shumë njerëz. Ky është një fenomen që nuk ka asnjë lidhje me vaksinimin, por me vetë virusin. Kufizimet e kontaktit dhe masat mjaft të njohura të higjienës janë mjete efektive për të mbërthyer infeksionin. Është si të themi një «garë me kohën», duhet të vaksinohemi sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të arrijmë imunitetin e tufës.

**Ju pyesni,  
Unia përgjigjet**

**Aksidenti: A do të përfitojë mëditjet për të dy vendet e punës?**

Unë jam ndihmëse shtëpiake dhe ka shumë vite që punoi për dy punëdhënës të ndryshëm. Në shoqatën Spitex punoi nja 15 orë në javë. Përpos kësaj punoi edhe në një amvisni private nga 4 orë në javë. Të enjten e fundit pësova një aksident: Jam rrëzuar nga biçikleta dhe kam nxjerrë krahun nga vendi. Nga mjeku im kam dëshminë për paaftësi pune të plotë deri në fund të qershorit. A do të përfitoi nga sigurimi aksidental pagën zëvendësuese?

**Philip Thomas:** Po. Të gjithë punësuarit në Zvicër janë të siguruar karshi aksidenteve. Të mbuluara janë aksidentet profesionale (në punë), ato jo profesionale dhe sëmundjet profesionale. Mirëpo: për tu punësuarit e pjesëshëm aksidentet jashtë-profesionale janë detyrimisht të siguruar, nëse orari javor i punës është së paku 8 orë tek në njëjtë punëdhënës. Aksidentet gjatë udhëtimit për dhe nga vendi i punës janë në çdo rast të mbuluara nga sigurimi aksidental. Pasi që në shoqatën e Spitex-it punoni 15 orë në javë, për aksidentin me biçikletë do të merrni përfitimin e siguruar ligjor. SE a ka ndodhur aksidenti gjatë udhëtimit për në punë, apo në shtëpitë, kjo nuk luan ndonjë rol. Sigurimi aksidental i shoqatës Spitex është i obliguar të bëjë kompensimin. Ju do të merrni mëditjet në lartësinë 80% të të ardhurave të siguruar. Për llogaritjen e përfitimit të mëditjeve do të llogariten të ardhurat nga të dyja punët e juaja.

(Work, 4 dhjetor 2020)

**Puna e shkurtuar: Sa është lartësia e kompensimit për punë të shkurtuar?**

Unë punoi si shitëse këpucësh në një shitore të vogël në Bernë. Shkaku i masave të reja në ndërlidhje me koronavirusin, nga 18 janari 2021 është mbyllur shitorja ku punoi. Shefja ime ka lajmëruar punë me orar të shkurtër për mua dhe kolegen time. Kolegja ime më ka thënë s ene do të marrim pagën tonë në lartësinë 100%, pasi ne kemi paga të ulëta. A është e vërtetë?

**Montaña Martín:** Varet nga ajo, se sa ju saktësisht fitoni. Me rastin e kompensimit për punë të shkurtuar në parim të punësuarit marrin 80% të të ardhurave të humbura, të kushtëzuara nga puna e shkurtuar. Me këtë rast merren parasysh edhe shtesat e rregullta të pajtuara me kontratë. Falë presionit të sindikatave në dhjetor është vendosur që për të gjithë që fitojnë më pak kompensime më të larta. Për punëmarrësit me të ardhura të ulëta deri në 3'470 franga nga 1 dhjetori 2020 kompensimi është 100%. Tek të ardhurat mbi 3'470 franga dhe më pak se 4'340 franga, kompensohet paga e plotë e humbur shkaku i punës së shkurtuar në lartësinë prej 3'430 frangave. Nga 4'340 franga, kompensimi për punë të shkurtuar është në lartësinë e rregullt prej 80%. Shkallëzimi i pagave të ulëta bëhet bazuar në pagën së punësimit të plotë. Klasifikimi i pagave të ulëta në punë të pjesëshme bëhet në bazë të pagës së përllogaritur të punës me orar të plotë. Duhet gjithashtu të theksohet se, gjatë punës me kohë të shkurtuar, kontributet e sigurimeve shoqërore paguhen plotësisht - d.m.th. si pa punë me kohë të shkurtuar. Kjo vlen për AHV/AVS / IV/AI, ALV/AC, sigurimin aksidental dhe sigurimi profesional (trusti pensional). Më shumë informacion mund të gjeni në <https://www.arbeit.swiss/secoalv/de/home/menue/unternehmen/versicherungsleistungen/kurzarbeit-covid-19.html>.



**Koronavirusi: Çka duhet të dini**

**Punëdhënësi im nuk ma ka paguar pagën e muajit të fundit. Çka mund të bëjë unë? A mund të më detyrojë që të vaksinohem? Përgjigje në këtë dhe shumë pyetje tjera që kanë të bëjnë me koronavirusin dhe të drejtat në vendin e punës në shumë gjuhë mund ti gjeni në: <https://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/coronavirus#c30941>**

**Zgjedhjet e parregullta parlamentare në Kosovë  
Demokracia, përfshirja dhe përfaqësimi në proceset shoqërore**

Në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë Mërgata duhet të jetë aktive në realizimin e të drejtave të tyre. Si në aspektin e mbrojtjes të drejtës së votës, duke kërkuar nga KQZ regjistrimin dhe votimin pa pengesa, ashtu edhe në kërkesën për përfaqësim në parlament dhe institucione. Partitë duhet që në mesin e kandidatëve në listat e tyre të kenë edhe pjesëtarë të dëshmuar të diasporës. Platforma «Zëri progresiv» inkurajon bashkëqytetarët, të cilët angazhohen për drejtësi sociale, ambient të shëndoshë dhe shërbime profesionale publike për të gjithë, pa dallime shoqërore, gjinore, nacionale, orientim seksual dhe fe, të prezantojnë kandidaturat..

Në emër të «Zërit progresiv» : Florim Kadriu, Aargau; Hilmi Gashi, Bern

Mërgata jonë ka qenë, është dhe do të jetë e rëndësishme për zhvillimet përparimtare në Kosovë, si në aspektet ekonomike, profesionale ashtu edhe në ato shoqërore dhe politike. Tash është pjekur koha, që mërgata dhe diaspora e gjerë të mos shihet më vetëm si një burim financiar, por edhe si resurs profesional dhe njerëzorë, për të qar përpara zhvillimet pozitive dhe përparimtare në vendin amë. Pjesëtarë të mërgatës tonë japin kontribut të madh në vendin ku jetojnë, si në jetën ekonomike, kulturore, sportive, po ashtu edhe në institucione shtetërore edhe në nisma private, ku japin dijen e tyre dhe krijojnë përvojë të madhe në funksionimin e strukturave të ndryshme të një shoqërie njerëzore. Çdo ditë e më shumë rritet edhe numri i tyre, të cilët janë aktiv edhe në politikë, si pjesëtarë të parlamenteve komunal dhe shpresojmë së shpejti edhe në nivel nacional.



Në kontekstin e Kosovës, ne jemi të bindur se qytetarët e Kosovës, të cilët janë politikisht aktivë në shtetet ku jetojnë, në këtë rast në Zvicër, duhet të bëhen pjesë e politikës dhe institucioneve të Kosovës. Ata kështu mund të japin kontribut në zhvillimin të tërësishëm shoqërorë përmes shkëmbimit, transferimit dhe ndërmjetësimit me qëllim për të arritur përafrimin e jetësimin edhe të vlerave themelore shoqërore, si liria, barazia, drejtësia, solidariteti, mirëqenia dhe zhvillimi i gjithanshëm.

**Interesat legjitime të mërgatës**

Hulumtimet e shumta të organizatave joqeveritare dhe universiteteve të Zvicrës, të cilat janë bë mbi mërgatën, kanë nxjerr në pah, se profesionistë të profileve të ndryshme të diasporës janë të motivuar që mësimet, shkathtësitë e përvojat e tyre të pasuruara arsimore, profesionale, kulturore, politike dhe ato të përgjithshme shoqërore t'i bartin dhe zbatojnë me përkushtim gjithandëj në vendin amë. Nga kjo përfiton shumë Kosova, sepse këta bijë të vendit nuk kanë nevojë për shpjegues,

përkthyes, shoqërues, strukturë e infrastrukturë të kushtueshme shtesë, sepse janë gjithmonë të interesuar në zhvillimet në vendin e tyre të origjinës dhe e shohin si obligim, që punën dhe angazhimin e tyre shumëvjeçar për një Kosovë të lirë, të pavarur dhe të suksesshme ta vazhdojnë edhe sot e tutje. Ky është një motivim i brendshëm shumë i çmueshëm.

Nga angazhimi në procese institucionale dhe ligdhënëse përfiton edhe mërgata e gjerë, sidomos kur është fjala të marrëveshjet ndërshtetërore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë i prekin interesat e tyre vitale si e drejta e qëndrimit, mbrojtja juridike, të drejtat sociale, e drejta për pensione. Deri tani këto interesa të mërgatës nuk janë trajtuar me prioritet të duhur nga institucionet vendore. Kjo duhet ndryshuar sa më shpejtë, me qëllim të mbrojtjes së interesave legjitime të mërgatës. Sidomos në raportet bilaterale mes Kosovës dhe vendeve ku jeton mërgata, duhet potencuar aspekti i forcimit të të drejtave dhe mënjanimi i politikave diskriminuese ndaj shtetasve të Kosovës në vendet nikoqire.

Për të mundësuar këtë, nevojitet përfshirja institucionale e pjesëtarëve nga mërgata me mandat të qartë të kontraktuar si nga shtetet amë ashtu edhe të atyre të vendeve ku jetojnë e vepron ata. Deri më tani aspekti financiar e ekonomik theksohet së tepërmi, duke u anashkaluar tërësisht kapitali ekzistues human i njerëzve të diasporës, dhe nevoja e tyre për mbrojtje dhe përmirësim të drejtave të tyre legjitime, si siguria e qëndrimit, e drejta për pensione, siguri shoqërore dhe shëndetësore etj.

**Mërgata si forcë dhe urë lidhëse**

Mërgata jonë nuk mund të reduktohet vetëm si lidhje emocionale me vendin e origjinës, por edhe si subjekt me të drejta kushtetuese dhe interesa të veçanta, të cilat duhet marrë parasysh kur flitet për proceset politike. Më tutje, mërgata nuk duhet të shihet vetëm në aspektin territorial, por të shihet si rrjet me një identitet transnacional. Mërgata jeton në një vend tjetër prej vendit të origjinës. Marrëdhëniet me vendet amë janë të shumëllojshme, prej atyre private e deri në raporte ekonomike dhe shoqërore. Mërgata jeton në një kontekst të diversitetit dhe këto rrjete transnacionale janë resurse të dobishme për zhvillimet në Kosovë.

Nëse politika vendore dhe institucionet e shohin këtë si pasurim, atëherë është koha që këto resurse të kanalizohen në procese frytdhënëse për Kosovën, por edhe për avancimin e të drejtave të mërgatës, pa marrë parasysh se ku ajo jeton dhe vepron. E drejta e votës dhe për tu zgjedhur janë të drejta themelore, të cilat duhet mbrojtur nga institucionet e vendit. Të flasësh për mërgatën, pa e kuqur atë në procese pozitive është qëndrim paternalist dhe në aspektin e afatmësëm dhe afatgjatë nuk i bën mirë as vendit, por as edhe mërgatës.



**Kush është «Zëri Progresiv»**

Platforma «Zëri Progresiv» përbëhet nga anëtarë kryesisht të krahut të majtë në Zvicër, politikanë shqiptaro-zviceranë, sindikalistë dhe qytetarë aktiv, të cilët angazhohen në çështjet të përgjithshme politike dhe shoqërore në Zvicër, duke përfshirë këtu mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, luftës kundër racizmit dhe ksenofobisë, drejtësi sociale, informim të drejtë. Në kontekstin e diasporës shqiptare dhe të shteteve ballkanike me popullsi shqiptare, Zëri progresiv përkrah proceset përparimtare dhe frymën demokratike, duke ruajtur dhe respektuar interesin e përgjithshëm të qytetarëve dhe qytetarëve.

